



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.
_____.2020

Burrel, më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: Operatorin Ekonomik: “NELSA ” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J71601012S**

Adresa: Tirane, Dajt, DAJT, Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460,
me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1.

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për Propozim - Mallra”** – Marrëveshje Kuadër - me disa
operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Numri i referencës së procedurës/ **Lotit Nr.2: REF-58973-05-26-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti Nr.2 “Blerje Mish Viçi dhe Pule”**, me fond limit për
shumatoren e çmimeve për njësi në vlerën: **929 (nëntëqind e njëzet e nëntë) lekë pa TVSH**,
Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër:
700 626 (shtatëqind mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH, me afat realizimi të
marrëveshjes kuadër **12 (dymbëdhjetë) muaj**.

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: **Nr. 32, datë 01 Qershor 2020**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e
çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “NELSA” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **J71601012S**

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera: **880 (tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH**.

2. Operatorin Ekonomik: “ERDIS” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **K71804011J**

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera: **895 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH**.

3. Operatorin Ekonomik: “4 S” Sh.p.k,

me numër Nipt-i: **L64425401K**

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera: **900 (nëntëqind) lekë pa TVSH**

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatorin Ekonomik: “4 S” Sh.p.k,

me numër Nipt-i: **L64425401K**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “4 S” Sh.p.k për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1 / 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) *Në rastet e furnizimeve të ngjashme të kryera me institucione shtetërore.*

- *Vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës ku në vërtetim të jetë e përcaktuar koha e furnizimit, vlera e realizuar si dhe vërtetim e realizimit me sukses të kontratës.*

b) *Në rastet e furnizimeve të ngjashme me subjektet private.*

- *Faturat tatimore shitjeje ku të jenë të shënuara saktë datat, artikujt ushqimore, sasitë, shumat si dhe emri dhe nënshkrimi i personit blerës.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur për vërtetimin e furnizimeve të ngjashëm me institucione shtetërore, konstatohet se, në vërtetimin e lëshuar nga institucioni nuk është përcaktuar vlera e realizuar nga ana Juaj.**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.6/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera, automjet të përshtatshëm ATV (frigorifer) ku të jetë i pajisur me gjurmues të temperaturës së mjetit gjatë periudhës së transportit (tahograf temperature) për transportin e mallrave i cili duhet të jetë i pajisur me Leje Higjeno-sanitare. Mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin: Leje Qarkullimi, Akt Kolaudimi, Policën e Sigurimit të mjetit, Taksën Vjetore si dhe Çertifikatë e Transportit.

- Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se, nga ana Juaj si operator ekonomik pjesëmarrës nuk është paraqitur dokumenti për shlyerjen e taksës vjetore për mjetin e paraqitur.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: “NELSA” Sh.p.k, me seli: *Tirane Dajt DAJT Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie 199/32, Hyrja 1*, me numër Nipt-i: **J71601012S**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **880 (tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH/** për shumatoren e çmimeve për njësi, **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **895 (tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH/** për shumatoren e çmimeve për njësi, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **19.06.2020**

Ankesa: **Nuk ka patur.**

Titullari i Autoritetit Kontraktor